



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programën për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 2/2016), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për subvencionimin e ndërmarrjeve private për çertifikim të sistemeve të cilësisë sipas ISO standardeve

1. Lëndë e thirrjes publike është kompensimi i pjesës së shpenzimeve të subjekteve afariste për çertifikimin e sistemit të cilësisë sipas ISO standardeve.

Në pajtim me pjesën II, A. – PËRKRAHJA DHE ZHVILLIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME, Masa 3. Kompensim i pjesës së shpenzimeve të subjekteve afariste për çertifikimin e sistemit të cilësisë sipas ISO standardeve nga Programi për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 2/2016), për këtë qëllim janë paraparë mjete në vlerë prej 800.000 denarë.

Për realizimin e kësaj mase, Ministria e Ekonomisë kompenson 70% të shpenzimeve të dëshmuara të subjekteve afariste, por jo më shumë se 100.000 denarë veç e veç për secilin subjekt afarist – kërkues të mjeteve.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë:

- ndërmarrjet private të cilat merren me prodhimi ose veprimtari shërbyese;
- ndërmarrjet private të cilat nuk kanë fituar subvencione gjatë vitit 2014 dhe 2015 në bazë të këtij qëllimi.

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formulari i plotësuar “Kërkesë ISO 2016” (mund të merret në arkiv apo në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
 - Formulari i plotësuar „ Deklaratë – 2016 “ , e vërtetuar te noteri (Deklarata nga kërkuesi për ndarjen e ndihmës shtetërore, mund të merret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
 - Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
 - Vërtetim për tatime dhe kontribute të paguara lëshuar nga Drejtoria për të hyrat publike, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
 - Marrëveshje midis kërkuesit dhe trupit çertifikues, lidhur gjatë vitit 2015 ose 2016 (data e Marrëveshjes të jetë para datës së çertifikatës së lëshuar). Nëse trupi çertifikues është nga jashtë, përveq marrëveshjes është e nevojshme të dorëzohet edhe përkthimi i marrëveshjes në gjuhën maqedonase nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor;
 - Çertifikatë e lëshuar gjatë vitit 2015 ose 2016 nga trupi çertifikues* për sistemet e menaxhimit;
- * Trupi çertifikues duhet patjetër të jetë i akredituar nga trupi akreditues i cili është nënshkruar i EA-MLA/IAF-MLA ose i akredituar nga Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë (IARM) ose të jetë në procedurë për akreditim në IARM. Çertifikata e lëshuar nga trupi çertifikues duhet të përmbajë shenjë/symbol për akreditim ose tekst i cili udhëzon në statusin e akredituar të trupit çertifikues.
- Dëshmia se trupi çertifikues është në procedurë për akreditim është Vërtetimi i dhënë nga IARM.
- Faturë/a nga trupi çertifikues;
 - Çertifikatë nga banka depozituese apo SWIFT në të cilin shihet se subjekti afarist tërësisht e ka kryer obligimin e tij ndaj trupit çertifikues në pajtim me Marrëveshjen;
 - Fletpagesë me vlerë prej 300,00 denarë (Qëllimi i pagesës: pagesë për taksë administrative, Pranues: Buxheti i RM, Llogaria e trezorit: 100000000063095, Llogaria: 840___ (varësisht nga komuna) 06116, Kodi i të hyrave dhe programa: 72593000).

Dokumentacioni i lartpërmendur dorëzohet në origjinal ose kopje.

Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e e dokumentacionit aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.

Thirrja publike është shpallur në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk dhe në www.konkurentnost.mk.

Kërkesat për subvencionim i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Zgjedhja e aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet të parapara me thirrjen publike do të bëhet në përputhje me parimin „I pari vjen i pari shërbehet”, respektivisht sipas dorëzimit të aplikacionit, deri në harxhimin e mjeteve në dispozicion.

Një aplikues mund të shfrytëzojë subvencion vetëm njëherë nga shpallja e thirrjes publike.

Kërkesat me dokumentacion të kompletuar, duhet të dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë, rr. „Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup, **deri më 31.05.2016**

rel: (02) 3093 525; (02) 3093 501
